Në 102 vjetorin e Shërbimit Pyjor Shqiptar të lançojmë lidhjen e Memorandumit të Bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës

FAQE 2

FKPKK
Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Shqipëri
www.forest-al.org

APPPK
Asosacioni i Pronarëve të Pyjeve Private, Kosovë
www.akppp.net

SHKURT 2025

Shpërndahet FALAS!

JETO GJELBËR

Në 102 vjetorin e Shërbimit Pyjor dhe 65 vjetorin e krijimit të Fakultetit të Shkencave Pyjore

FAQE 2

FSHP, kurrikula e orientuar drejt kërkimit, bazuar në modelin e Universitetit të BOKU-s në Vjenë

FAQE 5

FSHP, për 65 vjet ka qënë shtyllë e dijes, inovacionit dhe përkushtimit

Fjalimi me rastin e 65 Vjetorit të FSHP (Decan E. Toromani)

FAQE 3

Roli dhe Kontributi i pyjeve në ekonominë kombëtare

FAQE 8

Ndryshimi i perspektivës për zonat e mbrojtura në Shqipëri

FAQE 6

Në 102 vjetorin e Shërbimit Pyjor dhe 65 vjetorin e krijimit te Fakultetit të Shkencave Pyjore

Në 102 vjetorin e Shërbimit Pyjor dhe 65 vjetorin e krijimit te Fakultetit të Shkencave Pyjore, Agjencia Kombëtare e Pyjeve uron të gjithë stafin e punonjësve të këtij sektori, akademikët, pedagogët e nderuar, inxhinierët dhe teknikët e pyjeve.

"Gëzuar Ditën e Shërbimit Pyjor", dhe 65 vjetorin e FSHP-së, duke i falënderuar për kontributin dhe përkushtimin e treguar ndër vite.

Me mesazhin "Ne duhet të punojmë së bashku për të kontribuuar në Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve dhe ta konsiderojmë atë si një zgjidhje kyçe për mbijetesën tonë, nga ajri që thithim deri te druri që përdorim" le të bashkojmë forcat për të përmirësuar pyjet tanë.

Në 102 vjetorin e Shërbimit Pyjor Shqiptar të lançojmë lidhjen e Memorandumit të Bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës

Kemi kënaqësinë që në 102 vjetorin e Shërbimit Pyjor Shqiptar të lançojmë lidhjen e Memorandumit të Bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës, një hap i rëndësishëm për mbrojtjen e pasurisë natyrore të vendeve tona.

Ky bashkëpunim do të mundësojë përmirësimin e menaxhimit të resurseve pyjore, forcimin e kapaciteteve për mbrojtjen e pyjeve dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Qëllimet kryesore të këtij Memorandumi janë:

- **Plotësimi i detyrimeve përkatëse për aderimin e Shqipërisë dhe Kosovës në Bashkimin Evropian;**
- **Shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira, si dhe zgjidhjeve për përballimin e sfidave në arritjen e përputhshmërisë me objektivat e Qeverive respektive, si dhe masat për Ndryshimet Klimatike;**
- **Shtrirja e bashkëpunimit bilateral në fushën e pyjeve, në zbatim bashkëpunimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.**

Fjalimi me rastin e 65 Vjetorit të FSHP (DECAN E. TOROMANI)

FSHP, për 65 vjet ka qënë shtyllë e dijes, inovacionit dhe përkushtimit

I nderuar Prof. Sallaku, Rektor I Universitetit Bujqësor të Tiranës
E nderuara znj. Marika, Drejtoresh në Ministrinë eTurizmit dhe Mjedisit
I nderuar z. Kala, Drejtori i Agjensisë Kombëtare të Pyjeve
I nderuar z. Malaj Kryetar i Shoqatës së Specialistëve të Pyjeve
Të nderuar të ftuar, kolegë të respektuar, alumni dhe studentë të FSHP

Sot, jemi mblidhur për të festuar 102 Vjetorin e Sherbimit Pyjor dhe 65-vjetorin e Fakultetit të Shkencave Pyjore. Është një privilegj i veçantë të jem këtu mes vizionarëve, edukatorëve dhe pionierëve që kanë formësuar jo vetëm këtë institucion, por edhe shkencën pyjore në Shqipëri. Sot nderojmë vizionarët që hodhën themelet e këtij institucioni, festojmë arritjet dhe presim me entuziazëm sfidat që na presin përpara.

Për 65 vite, ky fakultet ka qenë një shtyllë e dijes, inovacionit dhe përkushtimit, duke përgatitur breza profesionistësh që kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshme në menaxhimin e pyjeve, ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ideja për krijimin e një shkolle të lartë për inxhinjerë pyjesh në Shqipëri është dhenë nga Mehdi Bej Frashëri në vitin 1930 kur mbante postin e Ministrit të Ekonomisë i cili ka theksuar se:

Mehdi Frasheri (minister i ekonomise, figure politike e rendesishme e kohes 1930-1940):

"Një masë shumë e rëndësishme për përmirësimin e gjëndjes së pyjeve, është ngritja e një shkolle të lartë për inxhinierë pyjesh dhe një shkolle të mesme pyjore. Përveç këtyre për të përgatitur një trupë rojtarësh të aftë ai propozon një shkollë praktike ku mund të stërviten një numër djemsh që dinë shkrim e këndim dhe kanë mbaruar shërbimin ushtarak. Ndërkohë që përgatitet personeli teknik shqiptar (të paktën për pesë–gjashtë vjet) të pajtohet personel i huaj nga vende asnjanëse."

Por konkretizimi i kesaj ideje mori rrugë në vitin 1959, kur ne 19 Tetor 1959 me VKM 368 u vendos te çelej Fakulteti i Pyjeve me kohe sudimi prej 4.5 vjetësh. Në këtë vit u ulen në bankat e shkollës 30 studentët e parë nga e gjithë Shqipëria ku shumica ishin ish teknikë pyjesh të etur për dije dhe më pas dhjetra të tjerë u ulën në bankat e shkollës që me përkushtim mbaruan studimet dhe më pas sherbyen me devotshmëri dhe profesionalizëm në detyrat që iu ngarkuan.

Në vitet e para të Fakultetit, stafi pedagogjik ishte i reduktuar në numër dhe përbëhej nga pedagogë të talentuar të arsimuar jashtë vendit si; Prof. Llaza Treska që njihet edhe si themelues i shkencës pyjore shqipëtare i arsimuar në France, Docent Ilia Nako i arsimuar për pyje në Itali, Izmini Nako e arsimuar për pyje ne Rumani, Prof. Alaudin Frashëri i arsimuar ne Austri dhe pedagoge të tjerë si Ilia Mitrushi, Temo Mandili, Skender Fico,Vezir Muharremaj. Akile Pite, Mirdash Kalo,Vito Koçi etj.

Nga fillimet e tij modeste, ky fakultet është rritur për t'u bërë një qendër ekselence, duke frymëzuar breza të tërë studentësh dhe studiuesish. Gjatë këtyre viteve, Fakulteti ka përballuar sfida dhe ka përqafuar ndryshimet, duke qëndruar gjithmonë besnik ndaj misionit të tij për të ofruar arsim cilesor dhe për të avancuar kërkimet shkencore.

Në dekadat e kaluara, Fakulteti i Shkencave Pyjore ka qenë në pararojë të avancimit të kërkimeve në silvikulturë, inxhinieri pyjore, ruajtjen e biodiversitetit duke mbështetur jo vetëm me specialistë, por edhe me ekspertize zhvillimin e sektorit të pyjeve në vend.

Në kete jubile në bankat e shkollës së këtij fakulteti janë diplomuar rreth 2800 specialistë të lartë të cilët kanë dhëne kontributin e tyre në zhvillimin e kësaj pasurie kombëtare nga Alpet Shqiptare deri në Konispol. Specialistët e përgatitur në bankat e këtij institucioni, që sot numërohen me mijëra, janë zëra udhëheqës në shkencat pyjore, qeverisjen e pyjeve dhe zhvillimin e politikave të sektorit. Arritjet e tyre,

(Vijon në faqen 4)

FSHP, për 65 vjet ka qënë shtyllë e dijes, inovacionit dhe përkushtimit

(Vijon nga faqja 3)

si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, janë një dëshmi e cilësisë së arsimit dhe formimit që kanë marrë ne këtë Fakultet.

Në harkun kohor 1959 - 1990 studimet në Fakultetin e Pyjeve bazoheshin në sistemin tradicional të edukimit sipas një kurikule mësimore me shtrirje 4.5 vjeçare ku edukimi në auditore ndërthurej me praktikat mësimore jo vetëm në klasë, por edhe në terren duke pergatitur specialistë të aftë për prodhimin. Pas viteve 1990 me ardhjen e demokracisë, stafi pedagogjik u përball me sfida të shumta për të reformuar kurrikulën mësimore dhe për ta përshtatur atë me atë të universiteteve Europiane. Falë mbështetjes së GTZ u bë e mundur bashkëpunimi me Universitetin e Gottingenit në Gjermani i cili u pasua nga reformimi i kurrikulës në departamentin e Pyjeve dhe kualifikimit të stafit nëpermjet specializimeve të shumta të kryera në këtë universitet ose edhe në universitete të tjera falë programeve si psh: Tempus. Ndryshimet tepër thelbësore si në formë, dhe më e rëndësishmja në permbajtje, pa anashkaluar vlerat pozitive të përvojës së kaluar, konsistuan në këto drejtime: riformulimi i planeve mësimore të dy degëve, shtimi i numrit të lëndëve me natyrë ekonomike; përfshirja, për herë të parë, e bllokut të lëndëve me zgjedhje; zgjerimi i formave të kontrollit të dijeve, duke zbatuar, krahas provimeve me gojë, dhe testimet me shkrim; formulimi i nje sere rregulloresh të reja; modifikimi i emrit të Fakultetit, si rrjedhojë e përshtatjes me gamën e gjërë të kurrikulave të ristrukturuara, nga “FAKULTETI I PYJEVE”, ne “FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE”; riorganizimi i Fakultetit, në dy njësi mësimore baze – Departamente, etj. Falë mbeshtetjes së GTZ u bë e mundur përmirsimi i bazës laboratorike dhe ndjekia e studimeve të doktoraturës në Gjermani nga disa pedagogë të rinj.

Gjatë këtyre viteve FSHP e zgjeroi bashkëpunimin e tij edhe me fakultete të tjera homologe në Itali, Francë, Greqi etj. Fakulteti, në veçanti mbas viteve ‘90, ka ardhur duke e rritur autoritetin e vet, dhe nëpërmjet antarësimit në disa organizma ndërkombetare,si: IUFRO, EFI, si dhe partneritetit në projekte të përbashkëta me shumë fakultete homologe, krahas atyre të cituar më lart, edhe me homologët në Padova, Sopron, Beograd, Zagreb, Sarajeve apo Athinë.

Pas vitit 2009 FSHP u anagzhua në nje projekt reformimi të studimeve Universitare sipas modelit 3+2 duke e përshtatur atë me sistemin Europian dhe ku për here të parë u fut nocioni i vlerësimit me pikë krediti. Duhet përmendur që stafi i FSHP ka qenë vazhdimisht i angazhuar për përditësimin e kurrikulave të moduleve sipas modeleve të kurrikulave te fakulteteve homologe duke bërë që ato të ekuivalentohen lehtësisht në vende të ndryshme në Europe apo edhe në Amerikë dhe Kanada.

Këtë fakt e dëshmon njohja e diplomave të lëshuara nga ky Fakultet nga studentët tanë që sot jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme anë e mbanë botës. Ndërsa për studentët që punojnë në tregun vendas sot ata i gjen te punësuar në bashki, Administratën e Zonave të Mbrojtura, MTM, Agjensinë Kombëtare të Pyjeve, profesion të lirë apo edhe në OJF në fushën e mjedisit.

FSHP si e vetmja qendër e kualifikimit pasuniversitar e realizoi me sukses këtë mision nëpërmjet hapjes së shkollës Pasuniversitare “Qeverisja Ekologjike e Pyjeve” dhe “Teknologjia e Drurit” dhe më pas pergatitjen e rreth 56 doktorantëve, pa përmendur këtu trajnimin e specialistëve që punojnë në prodhim apo në bashki nëpërmjet kurseve afat-shkurtra.

Fakulteti që në fillimet e veta, asnjëhere nuk e diferencoi apo veçoi punën mësimore nga kërkimi shkencor, si një binom i pandarë me ndikime pozitive në mësimdhenie. Në pergjigje dhe të apelit të ekonomise pyjore, për zgjidhjen e një game të gjërë problemesh aktuale apo të perspektivës, dhe mbi bazen e një bashkëpunimi real, stafi Akademik i Fakultetit, në saj dhe të një profesionalizmi gjithmonë e në rritje, ka arritur rezultate të dukshme si në fushën studimore ashtu dhe atë kërkimore - shkencore, duke e orientuar angazhimin e vet në drejtim të rritjes, shtimit, zhvillimit dhe vlerësimit te pasurisë pyjore.

Ndër aktivitetet e tjera shkencore, qe Fakulteti shënon në Kurrikulën e vet, përmenden dhe botime të dhjetra tekstesh mësimore, praktikumesh apo broshurash; organizime sesionesh shkencore të niveleve të ndryshme; pjesemarrje me referime e kumtesa në simpoziume e konferenca shkencore, brenda e jashtë vendit etj.

Një vemendje të veçantë stafi i FSHP i ka kushtuar dhe vazhdon ti kushtojë aktivitetit kërkimor dhe shkencor nëpërmjet shkrimit të artikujve shkencore dhe botimit të tyre në revista të huaja dhe pjesmarrjes në projekte me vlerë qindra mijera Euro me financim nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Disa nga projektet aktuale te fakultetit permendim;

- Përdorimi i teknikave inovative të pyllëzimit me dronë (UAV) dhe fizibiliteti i tyre në kushtet e Shqipërisë.
- Studimi i ripërtëritjes natyrore në grumbujt pyjorë të përshkruar me prerje ripërtëritëse gjatë periudhës 2010-2020 dhe përcaktimi i masave silvikulturore përmes qasjes “Forest Landscape Restoration – FLR”
- Ndikimi i rrallimeve te grumbujve pyjore te ahut (Fagus sylvatica L.) dhe te pishes se zeze (Pinus nigra Arn.) mbi mjedisin pyjor dhe cilesine e materialit drusor
- Kontrolli Biologjik i Grerës aziatike të Geshtënjës në Tropojë,Reç.
- Disa projekte COST

Investime të shumta janë bërë në përmirsimin e laboratoreve ekzistues dhe krijimin e laboratorëve të rinj si psh: laboratorit të gjeomatikes, CAD, mbrojties së Pyjeve, trajtimit termik të drurit etj. Ne kete 65 Vjetor, FSHP ka nisur një proçes reformimi ku kurrikula e tij do jete e orientuar drejt kërkimit, bazuar në modelin e Universitetit të BOKU-s në Vjenë. Nëpërmjet këtij reformimi do të synohet edukimi inter dhe transdisiplinor duke synuar një balancim të moduleve të shkencave natyrore, socio-ekonomike, teknike dhe moduleve te specializimit.

Sot, teksa shohim drejt së ardhmes, roli i shkencave pyjore është më i rëndësishëm se kurrë. Ndryshimet klimatike, shpyllëzimi dhe humbja e biodiversitetit janë sfida urgjente që kërkojnë zgjidhje inovative dhe qasje ndërdisiplinore. Në të njëjtën kohë, roli socio-ekonomik i pyjeve—sigurimi i jetesës, mbështetja e komuniteteve rurale dhe ofrimi i burimeve për zhvillim të qëndrueshëm—duhet të mbetet në qendër të punës sonë.

Fakulteti i Shkencave Pyjore është në një pozicion unik për të adresuar këto sfida. Duke integruar njohuritë tradicionale me teknologjitë më të avancuara, duke promovuar bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare dhe duke mbështetur brezin e ardhshëm të studiuesve dhe profesionistëve, ne mund të sigurojmë që pyjet tona të lulëzojnë për gjeneratat e ardhshme.Ky përvjetor është gjithashtu një festë e partneritetit me aktorë të ndryshëm. Jemi

(VIjon në faqen 5)

FSHP, kurrikula e orientuar drejt kërkimit, bazuar në modelin e Universitetit të BOKU-s në Vjenë

Nga fjala përshëndetëse e Prof. Fatbardh Sallaku, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës

Jemi mbledhur sot për të festuar 102 Vjetorin e Sherbimit Pyjor dhe 65-vjetorin e Fakultetit të Shkencave Pyjore. Per mua është një privilegj i veçantë të jem këtu mes jush, vizionarëve, edukatorëve që kanë formësuar jo vetëm këtë institucion, por edhe shkencën pyjore në Shqipëri.

Ne kete 65 Vjetor, FSHP ka nisur nje proçes reformimi ku kurrikula e tij do jete e orientuar drejt kërkimit, bazuar në modelin e Universitetit të BOKU-s në Vjenë. Nëpërmjet këtij reformimi do të synohet edukimi inter dhe transdisiplinor duke synuar një balancim të moduleve të shkencave natyrore, socio-ekonomike, teknike dhe moduleve te specializimit.

Fakulteti i Shkencave Pyjore është në një pozicion unik për të adresuar këto sfida. Duke integruar njohuritë tradicionale me teknologjitë më të avancuara, duke promovuar bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare dhe duke mbështetur brezin e ardhshëm të studiuesve dhe profesionistëve, ne mund të sigurojmë që pyjet tona të lulëzojnë për gjeneratat e ardhshme.

Faleminderit dhe e gëzuar102 Vjetorin e Sherbimit Pyjor dhe 65-vjetorin e Fakultetit të Shkencave Pyjore!!

FSHP, për 65 vjet ka qënë shtyllë e dijes, inovacionit dhe përkushtimit

(Vijon nga faqja 4)

mirënjohës për bashkëpunimet me agjencitë qeveritare (MTM;AKP;AKZM), organizatat ndërkombëtare (IUFRO; EFI; FAO), OJQ-të (Federata Kombëtare e Pyjeve), CNVP dhe aktorët e sektorit privat që kanë mbështetur misionin tonë ndër vite. Së bashku, kemi zhvilluar politika, kemi zbatuar projekte dhe kemi formuar liderë që po bëjnë ndryshime të prekshme në menaxhimin dhe ruajtjen e pyjeve.

Teksa festojmë 65 vjetorin, le të kujtojmë se nuk po nderojmë thjesht një histori – ne po ndërtojmë mbi të. Le te kujtojme me respekt të gjithe ata që kanë dhënë kontributin e tyre në këto 65 vite në këtë institucion. Në këtë ditë të shënuar disa prej tyre nuk janë midis nesh, por vepra dhe kontributi i tyre mbeten të paharruara në memorien e gjithësecilit prej nesh.

Ata desha, sot ti respektojmë dhe kujtojmë disi ndryshe me një duartrokitje të gjatë.

DEKANËT NDËR VITE:

Prof. Llazar Treska, Prof. Agron Reka, Prof. Bajram Xheko, Prof.Mihallaq Kotro, Prof. Anesti Postoli, Prof. Vath Tabaku, Prof. Leonidha Peri, Elvin Toromani (2024)

STAFI AKADEMIK

- Llazar Treska
- Kristo Qendro
- Akile Pite
- Zoi Toska
- Ilia Nako
- Panajot Koci
- Izmini Nako
- Mirdash Kalo
- Skender Fico
- Vito Koci
- Dhimitër Jance
- Bajram Xheko
- Anesti Postoli
- Vezir Muharremaj
- Sotir Dimoshi
- Seit Pere
- Caush Elezi
- Vasil Marku
- Shaban Daja
- Thimaq Lako
- Dhori Marjani
- Vasil Toci
- Orjon Ngjela
- Leka Gedeshi
- Pandeli Marku
- Fatmir Lacej
- Vasillaq Mine
- Nehat Collaku
- Elvin Toromani
- Edmond Pasho
- Ina Vejsiu
- Frenkli Shahaj
- Entela Lato
- Alketa Grepcka
- Doklea Quku
- Franceska Delia
- Saimir Beqo
- Firdus Haveraj
- Gladiola Malollari
- Ramadan Balla
- Qani Lipe
- Agron Reka
- Lambi Stefanllari
- Avram Haxhi
- Remzi Fushekati
- Ema Daja
- Vojsava Zegali
- Isku Progri
- Mihallaq Kotro
- Arsen Proko
- Arben Bejtja
- Ilir Myteberi
- Hajri Haska
- Leonidha Peri
- Ramiz Metaliaj
- Arben Alla
- Marsela Luarasi
- Enea Malaj
- Hektor Thoma
- Dritan Ajdinaj
- Holta Cota
- Erald Kola
- Armond Halebi
- Besar Shehu
- Alma Ahmeti
- Teuta Halilaj

STAFI NDIHMËS AKADEMIK

- Marjeta Kafazi
- Rruzhdi Kushta
- Fatos Bengu
- Ferid Sula
- Faik Lita
- Festime Vasili
- Merita Papajani
- Enkeleda Vila
- Edmond Alikaj
- Aida Pina
- Arjan Basha
- Fiqirete Beqiri
- Aida Bylyku
- Parid Dule
- Besnik Habipi
- Shpresa Branko

Fakulteti i Shkencave Pyjore do të promovojë punën e tyre nëpërmjet një nisme të marrë që të krijojmë “Fondin e artë të botimeve dhe publikimeve në fushen e pyjeve dhe industrise se drurit” ku padyshim do jenë të gjitha botimet e këtyre personaliteteve.

Le të ritheksojmë angazhimin tonë për ekselencë në arsim, kërkim-shkencor dhe kontribut ne zhvillimin e sektorit të pyjeve në vend. Le të frymëzojmë studentët që sot ndodhen në auditorët tanë për të ëndërruar më shumë dhe për të arritur më shumë. Së bashku, do të vazhdojmë ta bëjmë këtë Fakultet një burim frymëzimi, një nxitës të përparimit dhe një shtëpi për të gjithë ata që kërkojnë dije. Le të festojmë këtë rast të veçantë me krenari, mirënjohje dhe një përkushtim të përbashkët për një të ardhme edhe më të ndritur. Në emër të stafit akademik dhe administrativ, shpreh mirënjohjen më të thellë për të gjithë ata që kanë kontribuar në suksesin e këtij institucioni.

Pasioni, përkushtimi dhe vizioni juaj janë ato që e bëjnë Fakultetin e Shkencave Pyjore jo thjesht një institucion akademik, por një dritë shprese për mjedisin natyror të Shqipërisë dhe popullin e saj. Le të festojmë këtë rast të veçantë me krenari, mirënjohje dhe një përkushtim të përbashkët për një të ardhme edhe më të ndritur.

Faleminderit dhe e
gëzofshim 65 Vjetorin !
Mirë u pafshim në përvjetore të tjerë !

Ndryshimi i perspektivës për zonat e mbrojtura në Shqipëri

Nga Dr. Albora Kacani
(pjese nga manuali Komunitetet vendore dhe zonat e mbrojtura)

Zonat e mbrojtura luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e biodiversitetit,burimeve natyrore dhe vlerave kulturoretë lidhura me to. Ato kontribuojnë në mbrojtjen e natyrës, përmirësimin e jetesës së komuniteteve vendore dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Aktualisht, sipas INSTAT 2023 zonat embrojtura përbëjnë 21.7% të territorit tëShqipërisë (626,045 hektarë), ku shumica janë të kategorizuara si Monumente Natyre dhe janë zakonishttë vogla në sipërfaqe (Figura 1). Në vitete fundit, Shqipëria ka bërë përparime të mëdha në zgjerimin e rrjetit të zonave të mbrojtura, duke kaluar nga 5.2% në vitin 2005 në 16% në vitin 2014 dhe 21.7% në 2023 si pjesë e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Për rmenaxhimin e këtyre zonave është përgjegjëse Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), ndërsa menaxhimi ditor realizohet nga 12 Administrata Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) nëpërmjet rregullave të veçanta dhe për qëllime të ruajtjes. Megjithatë qasjet e ruajtjes në zonat e mbrojtura kanë ndryshuar duke marrë parasysh faktorët socialë dhe ekonomikë. Por duket se Shqipëria nuk ka bërë shumë progres në këtë aspekt.

Deri më sot kanë prirur t'i shohin njerëzit dhe natyrën si të ndara, shpesh duke përjashtuar komunitetet vendore nga zonat me interes, duke ndaluar përdorimin e burimeve të tyre natyrore dhe duke i parë shqetësimet e tyre si të papajtueshme me ruajtjen ose duke i mbrojtur a shpallur zona të mbrojtura pa miratimin e tyre. Prandaj kërkohet një qasje e re ecila kërkon përshtatjen ndaj situatave dhe sfidave të cilat marrin në konsiderate rrethanat sociale dhe ekonomike por edhe përkufizimet dhe praktikat ndërkombëtare. Këto të fundit kanë treguar se perceptimi i një zone të mbrojtur ka evoluar. Qëllimet e zonave të mbrojtura tani përfshijnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, ruajtjen e biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit. Më shumë vëmendje po i kushtohet respektimit të të drejtave të komuniteteve vendore dhe nevojës për përfshirjen e tyre në vendimet e menaxhimit të zonave të mbrojtura që prekin jetesën e tyre. Duke mos u fokusuar më vetëm në "mbrojtjen e natyrës", gjithnjë e më shumë profesionistë të zonavetë mbrojtura i shohin të ndëlidhur në mënyrë thelbësore burimet natyrore dhe njerëzit.

Sipas përkufizimit të IUCN, një "zonë e mbrojtur" është një hapësirë gjeografike e përcaktuar qartë, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar, nëpërmjet mjeteve ligjore ose mjeteve të tjera efektive, për të arritur ruajtjen afatgjatë të natyrës lidhur me shërbimet e ekosistemit dhe vlerat kulturore".

Komunitetet dhe zonat e mbrojtura: sfidat dhe mundësitë

Megjithëse egziston një prirje ndërkombëtare për të njohur të drejtat e komuniteteve vendore në menaxhimin e zonave të mbrojtura, kjo çështje ka marrë relativisht pak vëmendje në Shqipëri. Të paktën që prej vitit 2005 e deri më sot sipërfaqja e zonave të mbrojtura është katërfishuar (Grafiku 1). Shumë zona të mbrojtura u krijuan në toka dhe burime të cilat përdoreshin si pronë e përbashkët nga komunitetet që jetonin afër tyre. Këto ndryshimet që kanë ndodhur për shkak të rritjes së konsiderueshme të sipërfaqes së zonave të mbrojtura dhe qasjes ndaj tyre kanë shtuar më shumë shqetësimet për komunitetet vendore.

Përvoja ka treguar se ruajtja nuk mund dhe nuk do të ndodhë pa mbështetjen dhe përfshirjen e komuniteteve vendore. Ekzistojnë prova të shumta të bazuara nga përvojat në terren në shumë zona të Shqipërise që shpallja e një zone të mbrojtur – duke ndjekur qasjet konvecionale të zonave të mbrojtura – pa miratimin e komuniteteve i ka dëmtuar ata duke i bërë më të margjinalizuar. Kështu, disa komunitete janë përjashtuar nga zonat e reja të shpallura të mbrojtura, duke sjell shpesh pasoja socio-kulturore dhe ekonomike. Disa komunitete që i kanë përdorur këto zona tradicionalisht në

bazë të nevojave të tyre familjare janë gjendur përballë faktit që ato janë shpallur zonë e mbrojtur pa i konsultuar ata më parë. Komunitetet janë bërë më të pafuqishme ndërkohë që kontrolli dhe menaxhimi i zonave ku ata jetojnë është tashmë vetëm në dorë të qeverive vendore dhe kombëtare. Komunitetet shpesh i kanë ngritur këto probleme, por nuk janë marrë parasysh.

Roli i Komuniteteve në ruajtje

Së bashku me shfaqjen e shqetësimeve të komuniteteve, përvojat në terren tregojnë që ata luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen afatgjatë të burimeve natyrore. Njohuritë, aftësitë, praktikat dhe institucionet unike të komuniteteve kanë treguar që rrisin efektivitetin e ruajtjes.

Më poshtë përshkruhet përvoja e banorëve të fshatit Radomirë të Njësisë Administrative Kala e Dodës të Bashkisë Dibër. Falë traditës së tyre të pasur ata kanë krijuar një marrëdhënie të pandashme me tokën dhe burimet natyrore, bazuar në të drejtat zakonore kolektive të përdorimit të trashëguara brez pas brezi. Ata kanë ngritur institucione efektive të menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve me të cilat kanë të lidhur jetesën dhe identitetin e tyre kulturor. Ata gjithashtu pretendojnë "të drejta" për pyjet dhe burimet e tyre natyrore.

Njerëzit dhe pyjet e Radomirës: një traditë e ruajtjes së natyrës

Ishpallur si një nga 100 fshatrat turistikë të Shqipërisë, Radomira dhe njerëzit e saj kanë shumë për të ofruar!!! Fshati Radomirë shtrihet rrëzë malit më të lartë të vendit, malit të Korabit, në lartësinë rreth 1500 m mbi nivelin e detit. Fshati është një nga 8 fshatrat e njësisë administrative të Kalasë së Dodës që ndodhet në verilindje të Shqipërisë. Edhe pse numri i banorëve është zvogëluar në 30 vitet e fundit, banorët e Radomirës (radomirasit) që ende jetojnë atje janë të njohur për lidhjen e tyre të ngushtë me natyrën. Me kalimin e viteve kjo marrëdhënie ka marrë formën e marrëveshjes së pashkruar mes fshatarëve për të mbrojtur dhe administruar pyllin dhe kullotën pranë fshatit të tyre. Të gjithë fshatarët kanë rënë dakord bashkërisht të krijojnë një komitet të përbërë nga 5-6 persona përgjegjës për qeverisjen e pyjeve dhe kullotave. Ajo që e bën edhe më të veçantë eksperiencën e Radomirës është se komisioni ka caktuar një roje pylli për mbrojtjen e pyllit që paguhet çdo muaj nga vetë komuniteti. Komisioni monitoron çdo dy muaj situatën në pyll dhe punën e rojes. Përveç kësaj, fshati i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së pyllit nga zjarret, ku në disa raste përfshihen edhe gra dhe fëmijë. Por pyjet dhe kullotat e Radomirës jo vetëm mbrohen! Kur është e nevojshme, drurët e vjetër ose të shtrembër hiqen për të plotësuar nevojat për dru zjarri të komuniteteve vendore. Për familjet më të varfra të fshatit komisioni përcakton se çdo vit mund të priten 1-2 drurë për familje. Përsa i përket kullotave përsëri në bazë të vendimit të fshatit ato ndahen sipas familjeve. Çdo familje ka kullotën e saj duke respektuar kufijtë me familjet e tjera. Falë këtyre rregullave zakonore, Radomira është një model i qëndrueshëm i mbrojtjes dhe përdorimit të pyjeve dhe kullotave nga komunitetet lokale. Ndonëse 10 vite më parë fshati u bë pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik, radomiraanët vazhdojnë të ndjekin të njëjtat tradita si më parë.

Për të mësuar më tepër rreth traditës së përdorimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore në fshatin Radomirë mund të ndiqni videon

këtu:https://www.youtube.com/watch?v=YxB8JMlljh0

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave

Dokumentimi i përvojave të ndryshme, përfshirë përfitimet dhe dështimet, është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse objektivat strikte të mbrojtjes mund të jenë të pajtueshme me përfshirjen e komuniteteve. Gjithashtu, hulumtimi i marrëdhënies mes arritjes së objektivave të ruajtjes dhe

respektimit të të drejtave të njeriut është thelbësor për të krijuar modele të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Përfshirja aktive e komuniteteve vendore jo vetëm që mbështet ruajtjen, por siguron që nevojat dhe të drejtat e tyre të respektohen gjatë procesit.

Përshtatja e Politikave dhe Praktikave për Harmonizimin e Natyrës me Njerëzit

Ndërkohë që qarqet e politikave ndërkombëtare janë të përkushtuara për të harmonizuar natyrën me njerëzit, është e nevojshme që edhe në Shqipëri të hartohen programe dhe nisma që trajtojnë një sërë çështjesh, duke përfshirë:

Të drejtat e njeriut dhe respektimin e tyre brenda zonave të mbrojtura. Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore që ruan ekuilibrin mes ruajtjes dhe zhvillimit.

Pjesëmarrjen e shoqërisë civile në vendimmarrje për menaxhimin e këtyre zonave. Drejtësinë gjinore, duke përfshirë të gjitha grupet sociale në proceset e ruajtjes.Përfshirja e komuniteteve vendore në proceset e ruajtjes mbetet një çështje e diskutueshme. Ndërsa disa ekspertë shfaqin skepticizëm, veçanërisht kur kërkohen masa të rrepta mbrojtjeje, të tjerë theksojnë rëndësinë e përfshirjes së komuniteteve si një qasje efektive për ruajtjen afatgjatë. Kapacitetet, njohuritë dhe praktikat tradicionale e tyre janë provuar si faktorë kyç për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Dokumentimi i përvojave të ndryshme, përfshirë përfitimet dhe dështimet, është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse objektivat strikte të mbrojtjes mund të jenë të pajtueshme me përfshirjen e komuniteteve.

Gjithashtu, hulumtimi i marrëdhënies mes arritjes së objektivave të ruajtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut është thelbësor për të krijuar modele të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Përfshirja aktive e komuniteteve vendore jo vetëm që mbështet ruajtjen, por siguron që nevojat dhe të drejtat e tyre të respektohen gjatë procesit.

Hapa efektive për Përfshirjen e Komuniteteve në Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) dhe palët e tjera të interesuara që menaxhojnë ose bashkëmenaxhojnë zonat e mbrojtura kanë mundësi të shumta për të rritur efektivitetin e tyre në përfshirjen e komuniteteve. Një element thelbësor i këtyre mundësive është njohja e faktit se mbështetja e komuniteteve është e domosdoshme në rastet kur zonat e mbrojtura prekin jetesën dhe interesat e tyre. Për të arritur qëllimet e ruajtjes, është jetike të sigurohet bashkëpunimi i këtyre komuniteteve. Gjithashtu, është pranuar gjerësisht se zonat e mbrojtura nuk duhet të veprojnë në mënyrë që të dëmtojnë ose përjashtojnë komunitetet që jetojnë pranë tyre. Këto çështje janë theksuar gjatë takimeve në nivel vendor të mbajtura në Dibër,Kukës, Fier, Shkodër dhe Prrenjas në vitin 2024, ku morën pjesë përfaqësues të Administratës së Zonave të Mbrojtura, bashkive, shoqatave dhe vetë banorëve. Procesi i përfshirjes së komuniteteve si partnerë aktivë në menaxhimin e zonave të mbrojtura duhet të nisë që në fazat e para të planifikimit dhe projektimit. Kjo përfshin inkurajimin e pjesëmarrjes aktive të të gjitha palëve të interesuara dhe përgjigjen ndaj shqetësimeve dhe nevojave të tyre. Përmes një qasjeje pozitive, AKZM dhe/ose AdZM mund të zhvillojnë modele bashkëmenaxhimi që janë të përshtatura me karakteristikat dhe nevojat e komuniteteve vendore. Midis hapave/veprimeve të propozuara nga IUCN (të përshkruara më poshtë) për bashkëmenaxhimin, përfshihen ndarja e informacionit, kështillave dhe përfitimeve të ruajtjes me komunitetet. Gjithashtu, përfshirja e komuniteteve në konsultime për objektivat dhe vendimet teknike, si dhe fuqizimi i tyre për të marrë pjesë në proceset e menaxhimit, janë hapa kyç për të krijuar partneritete të suksesshme dhe efektive.

Roli dhe Kontributi i pyjeve në ekonominë kombëtare

Nga Klodiana Marika Drejtoresh në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Pyjet janë një nga burimet më të rëndësishme natyrore në Shqipëri. Ato janë një element i domosdoshëm i përdorimit të tokës dhe ekuilibrit ekologjik ndërkohë që sigurojnë diversitetin biologjik, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe përmbytjet, garantimin e rezervave ujore dhe cilësine e tyre si dhe produktivitetin me një vlerë ekonomike për shoqërinë. Pyjet ofrojnë akses në të mirat publike duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës me një theks të veçantë në zbutjen e varfërisë rurale. Pyjet sigurojnë të ardhura të drejtpërdrejta dhe punë në këto zona përmes prodhimit të lëndës së drurit, produkteve drusore jo drusore, bimëve mjekësore, etj.

Përfitimet dhe impakti i pyjeve, sipas kuptimit të përdorimit të tyre mund të kategorizohet në:

- Pyje për njerëz,
- Pyje për zhvillim,
- Pyje për ushqim,
- Pyje për natyrën, pasi ata luajnë një rol në uljen e temperaturave duke ulur njëkohësisht nevojën për energji. Përbëjnë shtratin e duhur për biodiversitetin, si dhe parandalues e luftues të mirë të përmbytjeve, erozionit dhe zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike.

Sipërfaqja e pyjeve në Shqipëri sipas të dhënave të Inventarit Kombëtar të Pyjeve (IKPK 2021) është rreth 1.3 milionë ha duke zënë 46% të sipërfaqes totale të vendit, dhe së bashku me kullotat zënë 65% të sipërfaqes kombëtare.

Pavarësisht se pyjet zënë 46% të sipërfaqes kombëtare, gjendja e tyre vlerësohet si jo e mirë dhe ka nevojë të ngutshme për mbrojtje nga aktivitetet e paligjshme, për investime në pyllëzime, përmirësime pyjore si dhe sistemime malore të cilat kanë efekte të menjëhershme në uljen e erozionit dhe reduktimin e ndjeshëm të përmbytjeve.

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE.

Kuadri rregullator dhe format e pronësisë Administrimi i pyjeve dhe kullotave dekadat e fundit ka pësuar ndryshime te shumta si rezultat i aplikimit të programeve përkatëse të forcave të ndryshme politike në mazhorancë por edhe reformave të ndryshme qeverisëse (si ajo territoriale, decentralizimi, institucionale, etj.)

Në vitet e fundit, pyjet po zënë një vend gjithmonë në rritje në agjendën politike dhe prioritetet e qeverisjes, nisur mbi të gjitha nga rëndësia e pyjeve për cilësinë e jetës, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe ruajtjen e ekuilibrave natyrorë. Zhvillime të rëndësishme mbi menaxhimin e sektorit të pyjeve janë në lidhje me:

- Reformën decentralizuese, me transferimin e të drejtave të pronësisë mbi pyjet tek bashkitë, ngritjen e një sistemi të ri të qeverisjes së burimeve pyjore me shumë nivele, duke ndërtuar një sistem të ri qeverisës për pyjet që duam.
- Vendosjen e një moratorium 10 vjeçar mbi pyjet (Shkurt 2016-Shkurt 2025), për të krijuar mundësi rikuperimi të këtij fondi, i cili është dëmtuar nga tranzicioni i tejzgjatur i ekonomisë.
- Dokumentin e Politikave për Pyjet, (miratuar nga Këshilli i Ministrave më, 31 Dhjetor 2018) që përcakton synimet strategjike dhe politikat për zhvillimin e sektorit të pyjeve deri në vitin 2030;
- Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, nën varësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në Korrik të 2019, strukturuar në shkurt 2020 dhe me fillimin e punës së saj shtator 2020);
- Miratimin e Ligjit të ri për Pyjet nr. 57/2020, i cili gjithashtu, parashikon miratimin/rishikimin e një sërë aktesh nënligjore (si VKM, udhëzime, urdhra, rregullore, etj.), në mënyrë që të garantohet efektiviteti i ligjit si dhe për të siguruar shpërndarjen e duhur të përgjegjësive të reja ose të rishikuara për secilin institucion të përfshirë ose palët e interesit.
- Krijimin e Regjistrit Kombëtar të Fondit Pyjor dhe unifikimin e tij me regjistrat e tjerë në vivel kombëtar, i cili do të jetë pjesë e rëndësishme e Sistemit Kombëtar të Informacionit për Pyjet

PROBLEMATIKAT E SEKTORIT PYJOR

- Furnizimi me dru zjarri për ngrohje i komunitetit dhe enteve publike, dhënia e kullotave për kullotje dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore, po has në vështirësi sepse nga bashkitë nuk janë bërë përpjektet e duhura për hartimin e planeve të mbarështimit për pyjet e kullotat në pronësinë të tyre. Hartimi i këtyre planeve vjen si detyrim ligjor, në bazë të nenit 11, pika 2, gërmat (b) dhe (c), e ligjit 57/2020, "Për pyjet";
- Vjelja dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore (BMËT), në pjesën më të madhe realizohet pa miratimin përkatës nga strukturat pergjegjese te Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit, mbi potencialet e mundësitë e tyre dhe pa patur parasysh shkallën e kërcënimit për këto bimë;
- Bashkitë, gjithashtu, nuk kane bërë sa duhet lidhur me realizimin e detyrimeve që kanë subjektet që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor/kullosor, si pasojë e heqjes nga fondi pyjor/kullosor;
- Bashkite nuk kane zbatuar me korrektësi detyrimet lidhur me përdorimin e burimeve financiare të siguruara nga aktivitetet në fondin pyjor e kullosor, në pronësinë e bashkisë, qe citon qe te ardhurat e gjeneruara nga aktiviteteet ne fondin pyjor, duhet te kalojne 100% ne drejtim te investimeve, pergatitjes se planeve te mbareshtimit, masave ndaj erozinit e degradimit te tokes e rritjes se kapaciteteve njerezore ne sektorin e pyjeve.

Kuadri ligjor

Ligji për pyjet 57/2020 – ligji kuadër për pyjet

Objektivat kryesore të ligjit:

- *ruajtja, rritja e sipërfaqes dhe rritjen e vëllimit të përgjithshëm të fondit pyjor kombëtar,*
- *rregullimi i marrëdhënieve dhe garantimin e stabilitetit financiar,*
- *organizimi funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes,*
- *shfrytëzimi dhe përdorimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i burimeve pyjore në raport me mundësinë që kanë pyjet, pa ndikuar në vazhdimësinë e jetës dhe ciklin e pyllit, si dhe*
- *garantimi i shërbimeve cilësore me synim mbrojtjen, përmirësimin dhe rigjenerimin e duhur të hapësirës pyjore.*

POLITIKA DHE KUADRI LIGJOR NËN BE

Ligji 57/2020 "Për Pyjet" vërejmë se është transpozuar plotësisht me nenet 4, 5 dhe 6 të Rregullores EUTR 995/2010 dhe përkatësisht:

a. Neni 27/8, detyron subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tregtisë së lëndëve drusore dhe produkteve pyjore jodrunore të zbatojnë sistemin e "due diligence" dhe të provojnë origjinën e tyre ligjore, përfshirë edhe certifikatën e origjinës;

b. Neni 27/9 detyron dhënien e certifikimit të cilësisë së produktit, duke përfshirë produktet drusore dhe jodrusore nga pylli, të kryer nga subjekte të akredituara sipas legjislacionit në fuqi.

- Njëkohësisht theksojmë se neni 19, i rregullores EUTR, është plotësisht i harmonizuar me nenin 36 të ligjit 57/2020, dhe jo vetëm, pasi prerja e paligjshme e pyjeve dhe vendosja e paligjshme e produkteve të drurit në treg konsiderohet tashmë vepër penale, në Kodin e Ri Penal të Republikës së Shqipërisë.
- Konteksti i politikave lidhur me EUTR, është shumëdimensional dhe përfshin një mori institucionesh dhe organizatash gjatë zbatimit. Gjithsesi, ligji bazë që propozon procedurat dhe rregullat për zbatimin e EUTR dhe FLEGT është ligji nr.57/2020 "Për pyjet", datë 30.04.2020.
- Kuadri ligjor që lidhet me EUTR përfshin akte ligjore dhe nënligjore, ku pothuajse të gjitha kanë hyrë në rrugën e përafrimit dhe harmonizimit me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian,

PLANET E ARDHSHME

Transpozimi i Acquis të BE-së për Pylltarinë (EUTR dhe FLEGT) dhe legjislacionit tjetër të nevojshëm (duke marrë parasysh rregulloren e re "Produkte pa shpyllëzim"), për të siguruar Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve. Kompletimi i legjislacionit për menaxhimin e pyjeve përmes zhvillimit të legjislacionit parësor dhe dytësor dhe instrumenteve ligjore për zbatim

RRITJA E NUMRIT TË KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË MTE

Forcimi i kapaciteteve administrative të AKU-së dhe autoriteteve lokale për SFM, duke përfshirë monitorimin dhe raportimin dhe parandalimin e zjarreve.

Fillimi i procesit të sensibilizimit të operatorit, sipas "sistemit të kujdesit të duhur", bazuar në shtyllat kryesore të pemës:

a. Aksesi në informacion

b. Procedura e vlerësimit të rrezikut

c. Procedura për zbutjen e rrezikut

Mbulimi i të gjithë fondit pyjor të Shqipërisë, me plane të reja menaxhuese pyjore, me synim përditësimin e informacionit në Sistemin Informativ Pyjor, si një bazë e mirë për gjurmueshmërinë e produkteve të drurit.